

STUDIM

Nëntor, 2024

# VLERËSIMI

I REFORMËS ADMINISTRATIVE  
DHE TERRITORIALE PËR  
QEVERISJEN VENDORE NË  
SHQIPËRI



**FRIEDRICH  
EBERT**   
**STIFTUNG**

## **IMPRINT**

Fondacioni "Friedrich Ebert"

Rr. "Kajo Karafili" Nd.14, Hyrja 2, Kati 1, Tiranë Shqipëri

### **Përgjegjëse:**

Katharina Hofmann-Drejtoreshë e Fondacionit „Friedrich Ebert“, Zyra e Tiranës

Tel: +355 4 22 509 86 / [www.tirana.fes.de](http://www.tirana.fes.de)

### **Menaxhere Programi:**

Jonida Smaja

### **Faqosja:**

Enea Protopapa

## **Instituti per Politika Publike dhe Private (IP3)**

"Instituti i Politikave Publike dhe Private" (IP3) është një organizatë e pavarur, jofitimprurëse në Shqipëri që ka si vizion zhvillimin e analizave të cilësisë së lartë me qëllim hartimin dhe zbatimin e politikave publike dhe private në fusha e sektorë të ndryshëm, në përputhje me qasjen dhe prioritetet europiane mbi lirinë individuale, qeverisjen e mirë, ekonominë e lirë të tregut dhe barazinë gjinore. Që nga viti 2012, IP3 është angazhuar në mënyrë aktive dhe ka kontribuar duke kryer kërkime dhe duke hartuar politika, duke prodhuar rezultate dhe rekomandime për reforma në fusha e sektorë të ndryshëm dhe të rëndësishëm për përshtetimin e integritetit të vendit në Bashkimin Evropian (BE).

Gjatë këtyre viteve, IP3 ka zbatuar dhe menaxhuar projekte në shkallë të gjerë duke ofruar asistencë teknike të specializuar dhe me cilësi të lartë në fusha të ndryshme si: Qeverisja e Mirë (Niveli Lokal, Rajonal dhe Kombëtar), Procesi i Decentralizimit & Reforma Territoriale, Ndërtimi i Kapaciteteve Vendore, Përmirësimi i Shërbimeve Lokale / E-Qeverisja, Zhvillimi Urban & Territorial, Zhvillimi Ekonomik Lokal & Rajonal; Zhvillimi i Qëndrueshëm i Turizmit; Promovimi i Trashëgimisë Kulturore; Përfshirja & Pjesëmarrja socio-ekonomike; Lehtësimi i Tregtisë dhe Rritja Ekonomike.

Në kuadër të projekteve të realizuara, IP3 ka krijuar një **rrjet të mirë marrëdhëniesh dhe bashkëpunimi** me të gjitha **bashkitë, agjencitë rajonale**, donator vendas e të huaj dhe autoritetet e qeverisë qendrore, si dhe shoqatat locale. IP3 përfaqëson një kulturë pozitive në vendin e punës duke njohur dhe theksuar një sërë vlerash thelbësore si integriteti, inovacioni, bashkëpunimi, puna në ekip, profesionalizmi dhe pasioni për punën e zhvillimin profesional.

Ky studim synon të analizojë ndikimin financiar të reformës administrative territoriale, duke përdorur vlerësime të detajuara ekonomike dhe fiskale.

*Përdorimi tregtar i të gjitha materialeve mediatike të publikuara nga Fondacioni "Friedrich Ebert" (FES) nuk lejohet pa pëlqimin me shkrim të FES-it.*

*Opinionet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të fondacionit "Friedrich Ebert".*

## **LISTA E SHKURTIMEVE**

<b>AMVV</b>	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
<b>OSHC</b>	Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC)
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>PBB</b>	Produkt i Brendshëm Bruto
<b>NJQV</b>	Njësi të Vetëqeverisjes Vendore
<b>AZZHB</b>	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
<b>RAT</b>	Reforma Administrative dhe Territoriale
<b>PKBZH</b>	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

## **LISTA E FIGURAVE**

Figura 1: Struktura e të ardhurave të veta vendore .....	14
Figura 2: Të ardhurat e veta vendore dhe shpenzimet e buxhetit vendor në raport me të ardhurat totale publike dhe shpenzimet publike dhe PBB-në në vite .....	15
Figura 3: Të ardhurat nga burimet e veta dhe ndryshimi i tyre në vite .....	16
Figura 4: Të ardhurat e veta vendore ndaj të ardhurave të përgjithshme publike dhe GDP në vite .....	16
Figura 5: Të ardhurat e veta lokale sipas burimit.....	17
Figura 6: Transfertat e pakushtëzuara dhe sektoriale dhe kundrejt PBB-së.....	18
Figura 7: Alokimi i transfertave sektoriale 2023 (buxheti fillestar).....	19
Figura 8: Ecuria e të ardhurave të veta kundrejt transfetës së pakushtëzuar 2015-2023 .....	19
Figura 9: Shpenzimet e pushtetit vendor dhe norma vjetore e rritjes .....	30
Figura 10: Pësja e shpenzimeve vendore ndaj PBB-së dhe shpenzimeve të përgjithshme publike.....	31
Figura 11: Detyrimet e prapambetura të pushtetit vendor.....	33
Figura 12: Shpenzimet kapitale dhe personelit kundrejt të ardhurave të veta .....	38
Figura 13: Shpenzimet kapitale dhe personelit kundrejt transfertave të pakushtëzuara sektoriale.....	38

## **TABELA E PËRMBAJTJES**

1. Hyrje.....	5
1.1 Rishikim i Reformës Administrative Territoriale në Shqipëri.....	5
1.2 Objektivat dhe Qëllimi i studimit.....	7
1.3 Metodologjia dhe burimi i të dhënave.....	8
2. Ecuria e Reformës Administrative Territoriale.....	9
2.1 Konteksti historik dhe arsyetimi për reformën.....	9
2.2 Ndryshimet kryesore të Reformës.....	11
2.3 Palët e përfshira në procesin e reformës.....	12
3. Implikimet ekonomike të reformës.....	14
3.1 Ndikimi në Buxhetet e Pushtetit Vendor.....	14
3.2 Ristrukturimi financiar në nivel lokal.....	22
3.3 Kapaciteti fiskal i bashkive të reja.....	25
4. Ndikimi në Shpenzimet Publike.....	28
5. Ndikimi në Zhvillimin lokal dhe Investimet.....	34
6. Ndryshimet në modelet e investimeve në nivel lokal.....	36
7. Konkluzione dhe Rekomandime.....	42
Referenca.....	44

# 1. HYRJJE

## 1.1 Rishikim i Reformës Administrative Territoriale në Shqipëri


**Reforma Administrative Territoriale (TAR)** në Shqipëri, nisi në vitin 2014 dhe përfaqëson një nga përpjekjet më të rëndësishme në lidhje me decentralizimin. Ajo synonte të adresonte sfidat e një strukture joefikase dhe të fragmentuar të qeverisjes vendore, e cila karakterizohej nga një numër i madh bashkish dhe njësie administrative të vogla që përballeshin me ofrimin e dobët të shërbimeve, kapacitetet e kufizuara financiare dhe mungesën e planifikimit strategjik. Qëllimi kryesor i Reformës Administrative Territoriale ishte krijimi i një sistemi më efikas, të qëndrueshëm dhe më të përgjegjshëm të qeverisjes vendore, që do të përmirësonte shërbimet publike dhe do të forconte institucionet në nivel vendor. Organizimi i ri territorial synonte rritjen e investimeve publike dhe ofrimin e mundësive më të mëdha për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

### Objektivat e reformës ishin:




Reforma u zbatua në disa faza, me konsultime gjithëpërfshirëse që përfshinin qeveritë vendore, organizatat e shoqërisë civile dhe ekspertë ndërkombëtarë. Në këtë drejtim, një nga autoritetet më të rëndësishme në këtë proces ishte Ministria e Brendshme, e cila luajti

një rol qendror në nxitjen e reformës, e mbështetur nga BE dhe donatorë të tjerë ndërkombëtarë. Procesi përfshiu ndryshime ligjore, ndryshime strukturore dhe iniciativa për ngritjen e kapaciteteve për të siguruar që autoritetet vendore të mund të menaxhonin me efektivitet përgjegjësitë e tyre të reja. Nga ana tjetër, zbatimi i reformës u përball me sfida të ndryshme kulturore dhe ekonomike.



Pas zbatimit të reformës, qeveria shqiptare u fokusua kryesisht në adresimin e sfidave në zhvillimin dhe përmirësimin e kapaciteteve të pushteteve vendore për të përballuar rolet e tyre të zgjeruara. Në këtë drejtim, prioritetet kryesore ishin qëndrueshmëria financiare, efektiviteti i decentralizimit dhe sigurimi që zonat rurale të përfitojnë nga përmirësimi i qeverisjes vendore.

Rezultatet dhe impakti i reformës konsistojnë në:



Sipas Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (2024), rezultatet kryesore të reformës konsistojnë në:

- Shpenzimet e buxhetit vendor në përqindje të PBB-së janë rritur nga 2.4% në 2015 në 3.2% në 2023.
- Kontributi në të ardhurat vendore është rritur nga 0.82% e PBB-së në 2015 në 1.37% në 2023.
- Të ardhurat e veta: të ardhurat e bashkive për vitin 2023 arritën në 35 miliardë lekë, të cilat janë rritur me 166% krahasuar me vitin 2015
- Taksa mbi pasurinë: rritur me 60%, nga 3.9 miliardë lekë në 2015 në 6.18 miliardë lekë në 2023
- Transferrat qeveritare: Transferrat e pakushtëzuara janë rritur me +40% gjatë së njëjtës periudhë.
- Detyrimet e prapambetura: bashkitë kanë arritur të ulin vlerën nga 12 miliardë lekë në 2015 në rreth 5 miliardë lekë në 2023.
- Investimet për frymë për periudhën 2015-2023 janë rritur përkatësisht me 78%, nga 3,773 lekë në vitin 2015, në 6,724 lekë në vitin 2023. Gjatë vitit 2023, njësitë vendore shpenzuan 16.56 miliardë lekë për investime.


## 1.2 Objektivat dhe Qëllimi i studimit

Reforma Territoriale dhe Administrative shënoi një moment kritik në përpjekjet e vendit për modernizimin e strukturave të qeverisjes. Bazuar në faktin që lidhej drejtpërdrejt me cilësinë e qeverisjes, TAR synonte të përmirësonte qeverisjen vendore, të rriste ofrimin e shërbimeve dhe të optimizonte efikasitetin administrativ. Përpara reformës, Shqipëria ishte e ndarë në shumë bashki të vogla që shpesh kishin probleme si pasojë e burimeve dhe kapaciteteve të kufizuara. Në këtë drejtim, reforma hodhi bazat për një administrim vendor më efektiv, duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe duke përmirësuar cilësinë e jetës për qytetarët. TAR gjithashtu ka trajtuar një sërë çështjesh të tjera si **procesi i decentralizimit administrativ dhe fiskal, të cilat duhet të analizohen në vazhdimësi.**

Në vitin 2022 u propozua nga Partia Demokratike e Shqipërisë (e cila përfaqësonte opozitën) rritja e numrit të bashkive, ku do të krijoheshin 33 bashki të reja nga bashkimi i rreth 100 njësive administrative. Ky riorganizim do t'i shërbente demokratizimit, transparencës dhe llogaridhënies së pushtetit vendor. Ndryshe, qasja e Partisë Socialiste të Shqipërisë ka qenë e fokusuar në zvogëlimin e numrit të komunave për të ngritur kapacitetet e tyre, si dhe për të qenë aktor aktiv në zhvillimin ekonomik të vendit.

Në këtë kuadër, është e rëndësishme vlerësimi i ndikimit financiar të TAR, bazuar në nivelin e të ardhurave, shpenzimeve dhe investimeve publike të NJQV-ve. Ky vlerësim do të shërbejë si një mjet monitorimi në lidhje me ecurinë e zbatimit të reformës territoriale, duke analizuar nëse janë arritur përfitimet e pritshme të saj, si dhe do të identifikojë çdo aspekt që mund të rregullohet me kalimin e kohës. Vlerësimi do të oforjë gjetje dhe rekomandime në lidhje me qasjen e një Reforme të re Administrative Territoriale, me vëmendje të veçantë tek çështjet që ende duhet të adresohen.





### 1.3 Metodologjia dhe burimi i të dhënave

Qëllimi i metodologjisë ishte vlerësimi i efikasitetit të zbatimit të reformës administrative territoriale. Kontributi i këtij vlerësimi është vlerësimi i ndryshimeve në efikasitetin e bashkisë si rezultat i një reforme strukturore që uli numrin e njësive administrative dhe vendore.

Metodologjia konsiston në mbledhjen e të dhënave nga burime dytësore, të cilat do të shërbejnë si bazë për të shqyrtuar nëse NJQV-të e formuara kanë përfituar financiarisht dhe nëse kanë fituar të ardhura të mjaftueshme buxhetore për një vetëqeverisje efikase. Si rezultat, është hartuar raporti që do të përfshijë gjetjet dhe rekomandimet.

## 2. ECURIA E REFORMËS ADMINISTRATIVE TERRITORIALE

### 2.1 Konteksti historik dhe arsyetimi për reformën

**Reforma Administrative Territoriale** në Shqipëri ishte rezultat i ndryshimeve të pësuar gjatë dekadave të në aspektin politik, social dhe ekonomik. Për të kuptuar kontekstin historik të reformës, është thelbësore të merret në konsideratë evolucioni i Shqipërisë nga një regjim i centralizuar komunist në një shoqëri demokratike, të orientuar nga tregu dhe përpjekjet e saj për të decentralizuar qeverisjen.

- Epoka komuniste dhe centralizimi (1946 - 1991)

Nën regjimin komunist (1946-1991), Shqipëria ishte një nga vendet më të centralizuara dhe më autarkike në Evropë, ku shteti kontrollonte të gjitha aspektet e jetës. Duke pasur parasysh këtë, pushtetet vendore kishin pak autonomi, pasi vendimmarrja ishte shumë e centralizuar në duart e Partisë Komuniste. Gjatë kësaj periudhe, Shqipëria u nda në rrethe (prefektura) të mëdha, të cilat u ndanë në njësi më të vogla dhe kishin pak fuqi apo kapacitet për t'i shërbyer popullatës vendase. Në këtë drejtim, koncepti i decentralizimit mungonte, pasi qeveria qendrore kishte kontroll të plotë mbi politikëbërjen vendore dhe shpërndarjen e burimeve.

- Tranzicioni postkomunist (1991 -2000)

Në vitin 1991, pas rënies së regjimit komunist, Shqipëria hyri në një periudhë tranzicioni politik dhe ekonomik drejt demokracisë, ku decentralizimi filloi të shfaqej si një çështje kyçe. Në fillim të viteve 1990, qeveria demokratike e sapokrijuar pranoi nevojën për të reformuar strukturat e qeverisjes vendore në mënyrë që të kishte një sistem më të përgjegjshëm dhe llogaridhënës. Ligji për Vetëqeverisjen Vendore (1991) shënoi fillimin e përpjekjeve për decentralizimin, duke transferuar disa kompetenca te pushteti vendor. Megjithatë, njësitë administrative vendore mbetën të vogla dhe të fragmentuara, duke u përballur me vështirësi të ndryshme.

Nga fundi i viteve 1990, sistemi i Shqipërisë nuk po funksiononte siç synohej, sepse qeveritë vendore ishin financiarisht të dobëta dhe të paafta për të trajtuar sfidat e zhvillimit rajonal të vendit. Duke pasur parasysh vështirësitë me të cilat përballleshin, si mungesa e kapaciteteve, përdorimi joefikas i burimeve dhe kornizat e dobëta

institucionale për qeverisjen vendore, u theksua akoma më shumë nevoja për një reformë më të thellë.

- Momenti i Reformës dhe Integritimit në BE (2000 – 2010)

Anëtarësimi në BE kërkonte përaftrim me standardet evropiane të qeverisjes, veçanërisht në aspektin e decentralizimit dhe demokracisë lokale. Në këtë drejtim, Shqipëria duhej të miratonte reforma që do të forconin qeverisjen vendore, do të rrisnin pjesëmarrjen e publikut dhe do të përmirësonin ofrimin e shërbimeve në nivel vendor.

U miratua **Ligji për Vetëqeverisjen Vendore** (2008), i cili synonte të forconte autonominë e qeverisjes vendore dhe të decentralizonte më shumë funksione tek bashkitë. Megjithatë, pavarësisht këtyre ndryshimeve ligjore, pushtetet vendore mbetën të pafinancuara dhe të fragmentuara. Si rezultat, ato nuk ishin në gjendje të ofrojnë shërbime në përputhje me nevojat e qytetarëve.

- Reforma 2011 – 2014

Viti 2011 shënoi një moment të rëndësishëm në historinë e Shqipërisë, pasi iu dha statusi i vendit kandidat në BE. Për t'u përshtatur me kërkesat e BE-së, u bë e qartë se reformat administrative territoriale ishin thelbësore për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike, reduktimin e pabarazive rajonale dhe krijimin e strukturave më efektive të qeverisjes vendore.

Gjithashtu, pakënaqësia në rritje e publikut për joefikasitetin e sistemit të qeverisjes vendore, veçanërisht në zonat rurale, nxiti vendimin e qeverisë për një reformë rrënjësore. Pushtetet vendore u konsideruan shumë të vogla, të fragmentuara dhe të dobëta financiarisht për të menaxhuar në mënyrë efektive burimet ose për të zbatuar strategji afatgjata zhvillimi. Për më tepër, bashkitë përballëshin me vështirësi të shumta për të përmbushur nevojat e qytetarëve të tyre.

- Reforma e vitit 2014

Nevoja për një reformë u njoh si nga palët e interesuara vendase ashtu edhe nga partnerët ndërkombëtarë, duke përfshirë Bashkimin Evropian, i cili e konsideroi atë një hap kyç drejt modernizimit të strukturave qeverisëse, uljes së korrupsionit, nxitjes së zhvillimit rajonal dhe përaftrimin e qeverisjes vendore me standardet e BE-së.

Qeveria shqiptare, me mbështetjen e partnerëve dhe ekspertëve ndërkombëtarë, nisi **Reformën Administrative Territoriale (TAR)** në 2014. Përpara reformës, Shqipëria ishte e fragmentuar në 373 bashki dhe komuna, gjë që i bënte qeveritë vendore të dobëta financiarisht, me aftësi të kufizuara për të ofruar shërbimet publike ose tërheqjen e investimeve. Përveç kësaj, ka pasur joefikasitet në alokimin dhe menaxhimin e burimeve publike, veçanërisht në zonat rurale dhe të largëta. Reforma synonte të adresonte joefikasitetin e strukturës administrative duke ulur numrin e bashkive dhe komunave nga 373 në 61, me qëllim krijimin e qeverisjeve vendore më të forta dhe më të afta që mund

të menaxhojnë më mirë burimet, të ofrojnë shërbime dhe të nxisin zhvillimin vendor. Reforma përfshinte gjithashtu masa të decentralizimit fiskal për të rritur autonominë financiare të qeverisjes vendore, duke u mundësuar atyre të kenë më shumë kontroll mbi buxhetet e tyre dhe të përmirësojnë ofrimin e shërbimeve publike.


Në këtë drejtim, miratimi i ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i hapi rrugë procesit të decentralizimit të funksioneve:

1. Administrimi dhe menaxhimi i pyjeve dhe kullotave
2. Administrimi dhe menaxhimi i kanaleve kulluese dhe vaditëse
3. Administrimi dhe menaxhimi i arsimit parashkollor
4. Administrimi dhe menaxhimi i rrugëve rurale
5. Administrimi dhe menaxhimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit.

## 2.2 Ndryshimet kryesore të Reformës

**Reforma Administrative Territoriale** reduktoi numrin e njësive të qeverisjes vendore duke bashkuar bashkitë dhe komunat në njësi administrative më të mëdha. Si rezultat, numri i bashkive të Shqipërisë u reduktua nga 373 në 61, me 12 qarqe të mbetura si njësi administrative dhe rajonale. Reforma synonte të nxiste një qeverisje më efektive duke u mundësuar autoriteteve vendore të bashkojnë burimet, të ndajnë ekspertizën dhe të ofrojnë shërbime më të mira për qytetarët.

Aspektet kryesore të reformës përfshinin:



## 2.3 Palët e përfshira në procesin e reformës

Reforma Administrative Territoriale në Shqipëri ishte një proces kompleks që përfshiu aktorë të ndryshëm, secili duke luajtur një rol vendimtar gjatë formësimit, zbatimit dhe mbështetjes së saj. Palët e përfshira mund të kategorizohen gjerësisht në aktorë vendas (institucionet qeveritare, autoritetet lokale dhe shoqëria civile) dhe aktorët ndërkombëtarë (qeveritë e huaja, organizatat ndërkombëtare dhe donatorët). Më poshtë jepet një përmbledhje e aktorëve kryesorë të përfshirë në proces:

### *Qeveria Shqiptare*

- Kryeministri dhe zyrtarët e qeverisë përcaktuan axhendën e reformës, mobilizuan mbështetjen politike dhe siguruan përafrimin me objektivat e zhvillimit kombëtar dhe të integritimit në BE. Ministrinë kryesore të përfshira në proces ishin:
  - **Ministria e Brendshme** si autoriteti kyç përgjegjës për menaxhimin e procesit të reformës. Kontributi i saj konsistonte në koordinimin e planifikimit, hartimit ligjor dhe zbatimit të reformës.
  - **Ministria e Financave** ishte përgjegjëse për adresimin e aspekteve të decentralizimit fiskal të reformës dhe sigurimin e mekanizmave financiarë për të mbështetur pushtetin vendor pas reformës.
  - **Ministria e Pushtetit Lokal dhe Administratës Publike**, e cila luajti një rol të rëndësishëm, veçanërisht në menaxhimin e aspekteve institucionale të decentralizimit.
- Kuvendi i Shqipërisë, i cili luajti një rol vendimtar në miratimin e legjislacionit dhe amendamenteve të nevojshme për reformën, si Ligji për Organizimin e Territorit dhe Njësitë Administrative (2014) që parashikoi kuadrin ligjor për krijimin e njërive të reja të qeverisjes vendore dhe procesi i decentralizimit.

### *Autoritetet Vendore*

- Njësitë e Qeverisjes Vendore (Bashkitë) ishin palët kryesore të interesit, si ato të prekura drejtpërdrejt nga reforma. Megjithatë shumë prej tyre fillimisht ishin rezistente ndaj reformës për shkak të frikës së humbjes së pushtetit apo kontrollit, secila bashki luajti një rol qendror në zbatimin e strukturave të reja qeverisëse dhe sigurimin e ofrimit të shërbimeve në njësitë administrative të ripërcaktuara.

### *Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC)*

- Organizatat e Shoqërisë Civile, të cilat kryen kërkime, ndërgjegjësovan dhe avokuan për një vendimmarrje më gjithëpërfshirëse, transparente dhe pjesëmarrëse në procesin e reformës. Roli i tyre ishte vendimtar për të siguruar që perspektivat e qytetarëve dhe grupeve vulnerabël të konsideroheshin gjatë fazave të planifikimit dhe zbatimit.

- Think Tank-et të cilat kanë kryer studime, kanë ofruar ekspertizë teknike dhe kanë vlerësuar ndikimin e reformës. Hulumtimi i tyre ndihmoi në informimin e rekomandimeve të politikave, duke theksuar si sfidat ashtu edhe mundësitë e paraqitura nga reforma.

#### *Organizata Ndërkombëtare dhe Donatorët*

- Bashkimi Evropian (BE) ishte një aktor i jashtëm i rëndësishëm, si mbështetës dhe nxitës i reformës, duke ofruar asistencë teknike, mbështetje financiare dhe udhëzime gjatë gjithë procesit të reformës, përmes projekteve dhe nismave të ndryshme. Ai mbrojti reformën territoriale dhe administrative si pjesë e përpjekjeve më të gjera të Shqipërisë për tu përafuar me standardet e BE-së, kryesisht në fushat e qeverisjes dhe decentralizimit. Veçanërisht, Delegacioni i BE-së në Shqipëri luajti një rol kyç në këshillimin e qeverisë shqiptare dhe koordinimin e asistencës evropiane në procesin e reformës.
- Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PKBZh) ishte një tjetër partner kyç ndërkombëtar i përfshirë në reformë, i cili ofroi ekspertizë teknike dhe mbështeti qeverinë shqiptare me iniciativa për ndërtimin e kapaciteteve për autoritetet vendore.
- Banka Botërore ka ofruar mbështetje financiare dhe asistencë teknike për Shqipërinë në fushat e reformës së qeverisjes vendore, decentralizimit fiskal dhe ndërtimit të kapaciteteve.
- Donatorë të tjerë si Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (AZZH), Ambasada Norvegjeze dhe USAID, gjithashtu luajtën role të rëndësishme, duke ofruar fonde, këshilla teknike dhe lehtësuan konsultimet dhe programet e trajnimit në nivel lokal për të ndihmuar në sigurimin e zbatimit të suksesshëm të reforma.

*Partitë politike*, veçanërisht ato të përfaqësuara në Parlament, ndikuan në drejtimin e reformës. Disa prej tyre ishin më mbështetës për konsolidimin, ndërsa të tjerët ngritën shqetësime për ndikimin në përfaqësimin dhe kontrollin lokal.

*Publiku dhe qytetarët*, veçanërisht ata që jetonin në zonat rurale pasi ishin ata që do të ndjenin më së shumti ndikimin e reformës.


*Mediat*, të cilat luajtën një rol thelbësor në ndërgjegjësimin e publikut, informimin e qytetarëve për objektivat e reformës dhe nxitjen e debatit publik për ndikimet e mundshme të saj, duke nxjerrë në pah aspektet pozitive dhe sfidat.

# 3. IMPLIKIMET EKONOMIKE TË REFORMËS

## 3.1 Ndikimi në Buxhetet e Pushtetit Vendor

Reforma Administrative Territoriale u fokusua në krijimin e qeverisjes vendore më efektive, por gjithashtu pati implikime të rëndësishme për financat e qeverisjes vendore. Ndikimi në buxhetet e qeverisjes vendore ka qenë pozitiv dhe sfidues, duke ndikuar si në gjenerimin e të ardhurave ashtu edhe në menaxhimin e shpenzimeve në nivel vendor.

Figura 1: Struktura e të ardhurave të veta vendore




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Një nga treguesit kryesorë të financave vendore janë të ardhurat e veta të NJQV-ve. Burimet më të rëndësishme në nivel kombëtar janë:

- Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (37%)
- Taksa mbi pasurinë (18%)
- Tarifa e pastrimit (13%)
- Të ardhura jotatimore (9%).

Kjo strukturë është e ngjashme me atë të vitit 2022, kur taksa e ndikimit në infrastrukturë përbënte 33% të të ardhurave, taksat e pasurisë 20% dhe tarifa e pastrimit 15%.

Figura 2: Të ardhurat e veta vendore dhe shpenzimet e buxhetit vendor në raport me të ardhurat totale publike dhe shpenzimet publike dhe PBB-në në vite



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)


Bazuar në figurën 2, gjatë dhjetë viteve të fundit, duke u nisur nga norma mesatare vjetore, të ardhurat nga taksat e veta të pushtetit vendor kanë një normë më të lartë rritjeje vjetore (11.9%) sesa të ardhurat e përgjithshme publike (7.2%). Një tregues i rëndësishëm është raporti i të ardhurave vendore ndaj PBB-së, sipas të cilit para reformës, në vitin 2012, të ardhurat e brendshme ishin vetëm 0.8% e PBB-së. Në vitin 2016, që përfaqëson vitin e parë të zbatimit të reformës, ato shënuan një rritje prej 1.02%. Në vitin 2023, të ardhurat vendore ishin 1.37% e PBB-së, duke shënuar një rritje të ndjeshme krahasuar me vitin para reformës.

Referuar konkretisht vitit 2023, ecuria e të ardhurave të veta është pozitive dhe me prirje rritëse. Në këtë kuadër, njësitë e qeverisjes vendore realizuan 34.9 miliardë lekë



të ardhura të veta, ose 12.9% rritje krahasuar me një vit më parë (30.9 miliardë lekë); nga të cilat taksat dhe tarifatat vendore arrijnë në rreth 31.7 miliardë lekë (91 për qind) dhe 3.3 miliardë lekë (9 për qind) vijnë nga të ardhurat jotatimore, duke tejkaluar planin e të ardhurave në buxhetin fillestar 2023 me rreth 9% dhe me rreth 14% të rishikuar. plani i të ardhurave buxhetore.


Figura 3: Të ardhurat nga burimet e veta dhe ndryshimi i tyre në vite



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Në vitin 2023, pushteti vendor grumbulloi rreth 34.9 miliardë lekë të ardhura të veta, nga të cilat rreth 31.7 miliardë lekë nga taksat dhe tarifatat vendore dhe rreth 3.3 miliardë lekë nga të ardhurat jotatimore. Sipas figurës së mësipërme, ritmi vjetor i rritjes së të ardhurave të veta është rritur në vitin 2023, gjatë të cilit njësitë e qeverisjes vendore kanë mbledhur 12,9% më shumë të ardhura të veta krahasuar me një vit më parë. Në këtë kuadër, rritja pozitive e të ardhurave të veta shërben si një tregues pozitiv për konsolidimin e shërbimeve që pushteti vendor u ofron komuniteteve.

Figura 4: Të ardhurat e veta vendore ndaj të ardhurave të përgjithshme publike dhe GDP në vite




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Një aspekt i rëndësishëm i menaxhimit financiar në nivel vendor është krahasimi i të ardhurave vendore me të ardhurat publike dhe produktin e brendshëm bruto. Gjatë vitit 2023, të ardhurat e veta vendore arritën në rreth 4,92% të të ardhurave publike dhe rreth 1,37% të PBB-së. Megjithatë, pjesa më e madhe e rritjes së të ardhurave erdhi nga rritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë (73% e rritjes), rritja e taksave të tjera (hoteli, prona, të tjera) dhe tarifa e pastrimit. Ky përqendrim i burimeve të veta vetëm në disa taksa dhe tarifa dëshmon varësinë ekonomike nga sektorë të caktuar. Në këtë kontekst, lind nevoja për diversifikim më të mirë të burimeve dhe shfrytëzim më të mirë të tarifave të shërbimeve, në mënyrë që komuniteteve përkatës t'u ofrohen shërbime cilësore dhe gjithëpërfshirëse.

Më poshtë është paraqitur në mënyrë të detajuar ecuria e të ardhurave të veta vendore sipas burimit dhe është paraqitur rritja e tyre gjatë periudhës 10-vjeçare, 2013-2023. Burimi me peshën më të madhe në të ardhurat vendore gjatë vitit 2023 është taksa e ndikimit në infrastrukturë me rreth 13.1% të të ardhurave vendore. Një nga burimet më të rëndësishme, si nga pikëpamja e peshës që zënë në totalin e të ardhurave vendore, por edhe e qëndrueshmërisë dhe potencialit në rritje si burim financimi, janë të ardhurat nga taksat mbi pasuritë e paluajtshme. Gjatë vitit 2023, pushteti vendor realizoi 6.18 miliardë lekë të ardhura nga tatimi në pronë, ku përfshihen taksa e ndërtimit (76%), taksë mbi tokën bujqësore (10%), taksë mbi tokën (4%) dhe tatimin e transaksioneve të pronës mbi pasuritë e paluajtshme (10%).

Figura 5: Të ardhurat e veta lokale sipas burimit



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)


Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale përbën një burim të rëndësishëm për financimin e funksioneve të pushtetit vendor. Gjatë vitit 2023, pushteti vendor ka

përfitur nga buxheti qendror në total rreth 33.87 miliardë lekë në formën e transfertave, të cilat ndahen në:

- 23.98 miliardë lekë ose afërsisht 71% transferta e pakushtëzuar e përgjithshme, e cila shpërndahet përmes formulës
- 9.8 miliardë lekë, ose 29% është në formën e transfertës së pakushtëzuar sektoriale për financimin e funksioneve të transferuara në nivel vendor.

Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme për vitin 2023 zë 1.1 % të Produktit të Brendshëm Bruto, duke plotësuar kështu edhe një kusht të rëndësishëm të BE në programin e mbështetjes buxhetore 'BE për Qeverisjen e Mirë (EU4GG), në përmbushjen e treguesve për disbursimin e transhit të katërt, referuar vlerësimit për vitin 2023 për Shqipërinë.


Figura 6: Transfertat e pakushtëzuara dhe sektoriale dhe kundrejt PBB-së



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)


Nga viti 2016 e në vazhdim, për funksionet e transferuara me ligj, bashkitë përfitojnë mbështetje buxhetore nga pushteti qendror në formën e transfertës sektoriale të pakushtëzuar, e cila në vitin 2023 arriti vlerën e rreth 9.8 miliardë lekë ose rreth 537 milionë lekë krahasuar me një vit më parë ose sa 29% e totalit të fondeve të transfertave të pakushtëzuara. Në raport me të ardhurat e veta të njëjësive të vetëqeverisjes vendore (34.9 miliardë lekë), transferta sektoriale e pakushtëzuar është rreth 33%.

Figura 7: Alokimi i transfertave sektoriale 2023 (buxheti fillestar)



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Figura 8: Ecuria e të ardhurave të veta kundrejt transfertës së pakushtëzuar 2015-2023





Burimi: Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (2024)

Transfertat nga qeveria qendrore: Në vitin 2015, të ardhurat e veta të bashkive shqiptare përfaqësonin vetëm 36% të të ardhurave të tyre kundrejt transfertës së pakushtëzuar. Rritja graduale e pjesëmarrjes së të hyrave vetanake ndaj transfertave në periudhën e analizuar dhe me raportin në vitin 2023 shënon një rritje prej 51%, mund të konsiderohet si një hap i rëndësishëm drejt fuqizimit të decentralizimit dhe rritjes së autonomisë financiare për vetëqeverisjen lokale.


- Decentralizimi Fiskal dhe Autonomia Financiare

Një nga komponentët kyç të reformës ishte **rritja e decentralizimit fiskal**. Duke konsoliduar bashkitë, reforma krijoi njësi më të mëdha me kapacitet më të madh fiskal, duke i lejuar ato të kenë më shumë kontroll mbi buxhetet e tyre dhe të menaxhojnë më mirë burimet. Në këtë drejtim, bashkitë kishin një autonomi më të madhe financiare.




- **Tranparenca Buxhetore dhe Llogaridhënia Publike**

Reforma synonte **të përmirësonte transparencën buxhetore dhe llogaridhënien publike** në nivel vendor, duke inkurajuar qeverisje më të mirë dhe përdorim më efektiv të fondeve vendore.




- **Menaxhimi dhe planifikimi i përmirësuar i buxhetit**

Bashkitë më të mëdha zakonisht përfitojnë nga përmirësimi i menaxhimit të buxhetit dhe planifikimit financiar, gjë që është thelbësore për efikasitetin e shpenzimeve publike.



➤ **Marrëdhëniet Ndërqeveritare dhe Decentralizimi Fiskal**


Duke rritur kapacitetin fiskal të qeverisjes vendore, reforma synonte të zhvendoste balancën e pushtetit dhe përgjegjësinë financiare nga pushteti qendror në atë vendor.



## 3.2 Ristrukturimi financiar në nivel lokal


- Rishpërndarja e burimeve financiare

Reforma solli ndryshime në rishpërndarjen e burimeve financiare nga pushteti qendror tek pushteti vendor. Transferrat financiare të qeverisë qendrore u përshtatën për të siguruar që bashkitë e reja të konsoliduara do të merrnin financimin e duhur.



- Sfidat me kapacitetin fiskal të bashkive të reja

Megjithëse reforma synonte të krijonte qeverisje vendore më të mëdha dhe më të afta, kapaciteti fiskal i shumë bashkive të reja ishte një sfidë e rëndësishme. Në shumë raste, bashkimi i bashkive më të vogla në bashki më të mëdha nuk rezultoi automatikisht në një menaxhim më të fortë financiar ose rritje të mbledhjes së të ardhurave. Në këtë kuadër, u ngritën disa çështje:



- Ndryshimet në modelet e të ardhurave dhe shpenzimeve lokale

#### Zgjerimi i bazës tatimore:

- Bashkitë më të mëdha, veçanërisht ato në zonat urbane, si rezultat i një baze më të gjerë tatimore, ishin në gjendje të rrisnin të ardhurat përmes taksave dhe tarifave vendore. Kjo i ndihmoi ato të mbulonin kostot e rritura të shërbimeve vendore pas reformës.

#### Rritja e kostove të ofrimit të shërbimeve

- Rritja e madhësisë së bashkive shpesh çoi në kosto më të larta administrative, sipas të cilave sipërfaqet më të mëdha nënkuptonin më shumë mirëmbajtje të infrastrukturës dhe shërbime sociale. Këto përgjegjësi të shtuara erdhën me nevoja më të larta për shpenzime, veçanërisht për bashkitë të cilave më parë u mungonin burimet apo infrastruktura për të menaxhuar në mënyrë efektive detyra të tilla.

#### Tërheqje e investimeve më të mira

- Bashkitë më të mëdha dhe më të qëndrueshme financiarisht janë më tërheqëse për investitorët. Kjo mund të rrisë potencialin e të ardhurave të bashkisë duke rritur aktivitetin ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës. Aftësia për të menaxhuar investime në shkallë më të madhe dhe projekte zhvillimore gjithashtu kontribuon në rezultate më të mira të shpenzimeve publike.

- Përmirësimi i shpërndarjes së burimeve për shërbimet sociale

Reforma synonte të krijonte qeverisje vendore që mund të menaxhonin më mirë shërbimet sociale, duke përfshirë arsimin, kujdesin shëndetësor dhe programet e



mbrojtjes sociale. Duke konsoliduar njësi më të vogla, qeveria mund të shpërndajë burimet në mënyrë më efektive për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve sociale nëpër rajone.

#### Investimet në arsim dhe shëndetësi

Në zonat rurale, ku qeveritë lokale shpesh përballen me nevoja për të financuar arsimin dhe kujdesin shëndetësor, reforma lejoi që bashkitë më të mëdha të bashkojnë burimet dhe të ndajnë fondet në mënyrë më efektive.

#### Shëndeti Publik dhe Mbrojtja Sociale

Rishpërndarja e burimeve mundësoi investime në programet e mirëqenies sociale, duke siguruar që grupet vulnerabel në zonat rurale dhe të pashërbyera mund të marrin më shumë vëmendje dhe mbështetje. Bashkitë më të mëdha ishin në gjendje të zbatonin strategji më të koordinuara për zbutjen e varfërisë, papunësinë dhe çështje të tjera sociale.

#### ➤ Rreziqet e gjenerimit të të ardhurave

Reforma synonte të rriste autonominë financiare të qeverisjes vendore duke ofruar një bazë më të gjerë tatimore. Bashkitë më të mëdha pritej të pozicionoheshin më mirë për të gjeneruar të ardhura nga taksat, tarifat dhe shërbimet vendore. Megjithatë, disa rreziqe financiare u shfaqën në kontekstin e gjenerimit të të ardhurave vendore:

- **Varësia nga transfertat e qeverisë qendrore:** jo të gjitha bashkitë kishin të njëjtin potencial për gjenerimin e të ardhurave. Zonat urbane me më shumë aktivitet ekonomik dhe një bazë më të madhe tatimore mund të gjenerojnë më shumë të ardhura, ndërsa bashkitë rurale me më pak biznese, vlera më të ulëta të pronave dhe popullsi më të vogël u përballën me vështirësi në mobilizimin e burimeve lokale. Kjo pabarazi detyroi disa bashki të vareshin shumë nga transfertat e qeverisë qendrore për të përmbushur nevojat e tyre fiskale. Nëse këto transfertat do të reduktoheshin ose nuk do të shpërndaheshin në mënyrë të përshtatshme, qeveritë vendore mund të përballeshin me mangësi buxhetore, duke e bërë të vështirë ruajtjen e ofrimit të shërbimeve ose financimin e projekteve investuese.
- **Efikasiteti i mbledhjes së taksave lokale:** Megjithëse bashkitë më të mëdha kishin më shumë burime administrative për të përmirësuar mbledhjen e taksave, shumë ende përballeshin me sfida në mbledhjen efektive të taksave, veçanërisht në zonat rurale ku shpesh kishte administrim të dobët tatimor. Pamundësia për të përmirësuar normat e pajtueshmërisë tatimore dhe për të menaxhuar me efikasitet

të ardhurat çoi në rrezikun e taksave të pambledhura, duke përkeqësuar më tej deficitet buxhetore.

### **3.3 Kapaciteti fiskal i bashkive të reja**

